



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITI OF LIPJAN

Ne mbështetje të nenit 108 / A të ligjit nr.04 / L-042 për prokurim Publik të Republikës së Kosovës, ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe pasur parasysh ankesën dorëzuar në Komunë nga **GOE “Taulant SHPK & Studio Hapsira SHPK.” Tiranë**, pjesëmarrës në tenderin **“Hartimi i projekteve Detale”** me nr. të Prokurimit **613-19-010-2-1-1** Autoritetin Kontraktues, respektivisht zyrtari Përgjegjes i Prokurimit nxerr këtë ;

VENDIM

I Refuzohet kërkesa (ankesa) e propozuar për shqyrtim si e pa baze, e Operatorit Ekonomik **GOE “Taulant SHPK & Studio Hapsira SHPK.” Tiranë** pjesëmarrës në tenderin **“Hartimi i projekteve Detale”** me nr. të Prokurimit **613-19-010-2-1-1**

RAPORTI I ZYRTARIT PËRGJEGJËS TË PROKURIMIT

	03.06.2019	05.06.2019	05.06.2019
Nënshkrimi i Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit 	Data e pranimit të kërkesës për shqyrtim	Data e fillimit të shqyrtimit të kërkesës	Data e dorzimit të raportit tek GOE “Taulant SHPK & Studio Hapsira SHPK.” Tiranë

Neni 108/A zgjedhja preliminare e mosmarrveshjeve

Me datë 03.06.2019 AK ka pranuar kërkesën për shqyrtim të lëndës nga **GOE “Taulant SHPK & Studio Hapsira SHPK.” Tiranë** pjesëmarrës në tenderin **“Hartimi i projekteve Detale”** me nr. të Prokurimit **613-19-010-2-1-1** e inicuar nga (AK – Komuna e Lipjanit) – Zyra e Prokurimit.
Konform Neni 108/A pika 6 të LPP dhe konform kërkesës të datës 03.06.2019 zyrtari përgjegjës i prokurimit ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën me titull: **“Hartimi i projekteve Detale”** me nr. të Prokurimit **613-19-010-2-1-1**

Procesi i prokurimit :

Data e njoftimit për kontratë	25.03.2019
Lloji i procedures se aplikuar	e hapur
Lloji dhe vlera e kontrates se aplikuar.....	Sherbim/madhe
Afati i fundit për dorzimin e ofertave	06.05.2019
Data e hapjes se ofertave	06.05.2019
NJOFTIM PER VENDIMIN E AK.....	28.05.2019
Data e planifikur per nenshkrim te kontrates	03.06.2019

Rexhistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike.

1.	GOE TAULANT SHPK; STUDIO HAPSIRA SH.P.K.	0.71
2.	GOE Arhiko .ING O.P.; P.M.N. SH.P.K.	1.11
3.	N.N.SH. " Vizion Project "	1.23
4.	GOE N.SH. 3 D - PROJECT ; N.P. Premium - ENG	1.30
5.	GOE N.N.SH. ENI - DESIGN ; AL Engineering SH.P.K.	1.47
6.	GOE,, ENGRUP SH.P.K.; PRO-ART-ING SH.P.K.	2.19
7.	GOE " Infra-Plus " SH.P.K.; " PLAN 2 " SH.P.K.	2.28
8.	GOE N.P.N. ENG-IDEA ; SIB-BKA SH.P.K; N.N.P. PROJEKT - ING SH.P.K.	2.42
9.	GOE ,Enggroup SH.P.K.AL - GROUP SH.P.K.	10.15
10.	N.T.SH." INLINE ENGINEERING "	25.80

Pas ekzaminimit dhe vlersimit te tenderve si OE i suksesshem mbet GOE

1.	GOE "ENGRUP SH.P.K.; PRO-ART-ING SH.P.K.	2.19
----	--	------

Komisioni pas vlersimit te ofertave te OE konstaton se kan ofertuar 10 (dhjete) OE prej tyre tete jane te papergjegjshem ,andaj rekomandojme GOE,Endrup SH.P.K.:Pro-Art Ing "SH.P.K. per lidhje kontrate me qmimin me te ulet te pergjegjshem

Komisioni punen perfundon me date: 28.05.2019

Analizat dhe sqarimet e zyrtarit Pergjegjes te Prokurimit.

Zyrtari Pergjegjes i Prokurimit pas shqyrtimit te rrjedhes se procedures se tenderimit dhe pretendimeve te pales ne kerkese (ankese)sqaron si vijon

Ne pikat qe pretendoni si: Shkelje e ligjit te Prokurimit Publik.

1.Pretendimi juaj per piken e pare:

Ne kerkese te AK tek kapaciteti teknik dhe profesional eshte kerkuar qe te jete nje inxhinier i Komunikacionit, pas vlersimit te ofertes suaj juve ju mungon inxhinieri I komunikacionit poashtu nuk eshte as ne liste te stafiit i parapar ky inxhinier.

2.Pretendimi juaj per piken e dyte:

Kerkesa e AK ka qene, Menaxheri i kontratës Nje inxhinier i diplomuar i arkitekturës ose inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisëdrejtimi konstruktiv, sistemi 5 vjeqar ose master (min. 10 vjet provojë pune nga Diplomimi)

Pas vlersimit te ofertes tuaj juve ju mungon emrimi i menagjerit per kete projekt.

3. Pretendimi juaj per piken e tretë:

Kerkes e AK ka qene Per diplomat e fituara jashte Republikes se Kosoves kerkohen qe te jene te Nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Republika e Kosoves

Gjate vlersimit te ofertes tuaj inxhinierat qe kane qene te diplomuar jashte Republikes se Kosoves dhe nuk kane te nostrifikuara diplomat nga Ministria e Arsimit, (keta inxhinier qe jane parapar te sherbejne per projektim per KK Lipjan duhet qe te jene me diploma te nostrifikuara)

4. Pretendimi juaj per piken e kater:

Sigurimi i ofertes tuaj nuk eshte bere ne emer te konzorciumit as ne emer te Liderit te GOE por eshte bere nga vetem nga antari i dyte i konzorciumit, ju e perkisni kete sigurim dhe mund ta shikoni

Ne si AK dhe komisioni i caktuar per vlersim te ofertave pjesmarrese deklarojme qe ofertat jane vlersuar me pergjegjesi te plote duke respektuar LPP

Asnjera nga pikat e LPP nuk eshte shkelur nga ne si AK .

Zyrtari pergjegjes i Prokurimit bazuar ne sqarimet e cekura ne raport mendon qe AK per aktivitetin e Prokurimit me titull: ***"Hartimi i projekteve Detale"*** me nr. të Prokurimit **613-19-010-2-1-1** ka respektuar ne tersi dispozitat e LPP-se ne fuqi

Gjithashtu zyrtari pergjegjes i Prokurimit ankesen e GOE "Taulant SHPK & Studio Hapsira SHPK." Tiranë, e konsideron te PA BAZË.

Zyrtari pergjegjes i Prokurimit nga provat e prezantuara me larte vendosi si ne dispozitiv te ketij Vendimi. Keshilla Juridike:

Kunder ketij Vendimi Pala e pakenaqr me ankese mund ti drejtohet OSHP-se sipas Ligeve ne fuqi.

Zyrtari pergjegjes i Prokurimit i AK

Më datë: 05.06.2019

